



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 9096/2 Prot.

Fier më. 22.07.2026

V E N D I M

Nr. 60, datë 22.07.2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE
“ VAJKAN LIBOFSHË ”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, neni 54, gërma “k”, Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, të ndryshuar, kreu III neni 11, Ligjit nr.114/2024 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin, ‘Bashki të Forta (BTF), Faza 2’, si dhe urdhërit të Titullarit me nr. 743 prot., datë 20.01.2026, « Për ngritjen e Grupit të punë për hartimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve 2026-2036, të Bashkisë Fier », Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore “ Vajkan Libofshë “, për periudhën 2026-2036, sipas materialit të përgatitur nga Grupi i Punës, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave administrative – ligjore për miratimin e Planit të Mbarështimit në Ministrinë e Mjedisit ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit, Sektori i Pyjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) dite pas shpalljes

KRYETARI I KËSHILLIT

Melsi Bogdani

